



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

**Palëve:**

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**, i përfaqësuar nga **z. Besnik  
DERVISHI** (më poshtë “Zyra e Komisionerit”)

dhe

**INSTITUTI I NXËNËSVE QË NUK DËGJOJNË**, i përfaqësuar nga **znj.  
Orjola IDRIZI** (më poshtë “INND”)

dhe

**INSTITUTI I NXËNËSVE QË NUK SHIKOJNË “RAMAZAN  
KABASHI”**, i përfaqësuar nga **z. Emiliano LULE** (më poshtë “INNSH”)

Të ndërgjegjshëm për rolin dhe detyrat e rëndësishme që Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi parashikon për funksionimin e Zyrës së Komisionerit në promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut;

Në respekt të rolit dhe misionit të veçantë edukativ për komunitetin që kanë këto dy institute arsimore, si dhe;

Në funksion të pjesëmarrjes në mirëqeverisje e në ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve;

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

## **Neni 1**

### **Objekti dhe qëllimi**

Objekti i kësaj Marrëveshje është institucionalizimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit për çështje që prekin objektin e veprimtarisë së tre palëve, me qëllim:

- a) angazhimin e përbashkët për njohjen dhe ndërgjegjësimin me qëllim ushtrimin efektiv të të drejtave themelore të njeriut;
- b) angazhimin për trajtimin e rasteve të individëve që u përkasin këtyre komuniteteve në raport me veprimtarinë e organeve të administratës publike apo entiteteve private, në optikën e fushës së përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit;
- c) lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis palëve me qëllim të orientimit/adresimit të problematikave të këtyre individëve/komuniteteve pranë institucioneve kompetente;
- d) organizimin e aktiviteteve/iniciativave të përbashkëta në përputhje me objektin e veprimtarisë së palëve.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, ligji nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*.

## **Neni 3**

### **Fushat e bashkëpunimit**

Zyra e Komisionerit, INND dhe INNSH angazhohen të bashkëpunojnë për:

- i. monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve në ushtrimin e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
- ii. ndjekjen me prioritet të ankesave sipas fushës së përgjegjësisë të Zyrës së Komisionerit dhe/ose përcjelljen e tyre për shqyrtim pranë insitucioneve/organeve kompetente;
- iii. identifikimin e çështjeve me qëllim propozimin e iniciativave për ndryshime rregullatore në rritjen e cilësisë së shërbimeve për komunitetet respektive;
- iv. organizimin e trajnimeve për forcimin e kapaciteteve administrative institucionale;

- v. organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin dhe ndërgjegjësimin mbi ushtrimin e këtyre të drejtave;
- vi. shkëmbimin në mënyrë të vazhdueshëm të njohurive dhe praktikave të reja në këto dy fusha;
- vii. hartimin dhe prodhimin e materialeve ndërgjegjësuese si video/audio, fletëpalosje, broshura, etj, për këto komunitete;
- viii. përshtatjen teknike të faqes zyrtare në internet të Zyrës së Komisionerit me qëllim aksesueshmërinë e këtyre komuniteteve në marrjen e informacioneve të domosdoshme.

#### **Neni 4**

##### **Angazhimet e palëve**

1. Palët nënshkruese angazhohen të ndjekin objektivat e përcaktuara në këtë Marrëveshje, me qëllim që së bashku të rrisin efikasitetin institucional dhe të forcojnë bashkëpunimin mes tyre për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të çdo personi.
2. Për realizimin e parashikimeve të kësaj Marrëveshje, palët zhvillojnë takime periodike mes përfaqësuesve të tyre për diskutime mbi plotësimin e objektivave dhe vazhdimësinë e këtij dokumenti.

#### **Neni 5**

##### **Personi i kontaktit**

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë një person kontakti.
2. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë shkresore zyrtare dhe/ose me e-mail, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
3. Pikat e kontaktit do të jenë në dispozicion në çdo kohë për komunikim dhe koordinim me palën tjetër.

#### **Neni 6**

##### **Mirëbesimi**

1. Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera midis tyre në lidhje me këtë Marrëveshje si dhe do të zbatojnë çdo detyrim që rrjedh nga legjislacioni lidhur me dokumentacionin e administruar respektivisht.

**Neni 7**  
**Dispozitat e fundit**

1. Palët marrin përsipër përbushjen e objektivave të parashikuara në këtë Marrëveshje.
2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar.
3. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.
4. Marrëveshja përpilohet në 6 (gjashtë) kopje, nga dy për secilin institucion.

**PËR**  
**KOMISIONERIN PËR TË**  
**DREJTËN E INFORMIMIT**  
**DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**

**Besnik DERVISHI**

**PËR**  
**INSTITUTIN E**  
**NXËNËSVE QË NUK**  
**DËGJOJNË**

**Orjola IDRIZI**

**PËR**  
**INSTITUTIN E**  
**NXËNËSVE QË NUK**  
**SHIKOJNË**  
**“RAMAZAN KABASHI”**

**Emiliano LULE**

**Tiranë, më 21.12.2022**